

LIGJ
Nr. 10 033, datë 11.12.2008

PËR LOJËRAT E FATIT
(Ndryshuar me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)
(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e nevojshëm ligjor për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të lojërave të fatit, lejimin e organizatorëve dhe licencimin e tyre për ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, si dhe mbikëqyrjen e kësaj veprimtarie.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton llojet e lojërave të fatit, kushtet, kriteret dhe procedurat, që rregullojnë këtë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrat, përgjegjësitë dhe bashkëpunimin e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Fusha e zbatimit të këtij ligji përfshin subjektet, që ushtrojnë veprimtarinë sipas llojeve të lojërave të fatit, të parashikuara në nenin 5 të këtij ligji dhe autoritetin e mbikëqyrjes dhe të kontrollit të tyre.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Lojëra fati” janë lojërat e përcaktuara në këtë ligj, ku pjesëmarrësit paguajnë

një shumë të caktuar dhe u jepet mundësia e fitimit në para, sende apo të drejta të tjera, ku faktori fat ka ndikim të drejtpërdrejtë si në fitimin, ashtu edhe në humbjen e pjesëmarrësve në secilën lojë.

Nuk vlerësohen lojëra fati:

a) konkurset, që zhvillohen në bazë të njohurive të pjesëmarrësve, ku fituesi merr një çmim të caktuar, të vendosur për këtë qëllim;

b) pagesat, që bëhen nga sigurimi i jetës ose llojet e tjera të sigurimit, nëpërmjet tërheqjes me short të biletave, të emetuara për këtë qëllim.

2. “Organizator” është personi juridik, i cili lejohet të ushtrojë veprimtari në fushën e lojërave të fatit, në zbatim të dispozitave të këtij ligji.

3. “Mjetet e lojërave” janë mjetet elektrike, elektronike ose mekanike, që përdoren ose synohet të përdoren për të luajtur lojëra fati dhe funksionimi i të cilave ka një ndikim në rezultatin e lojës.

4. “Publicitet” është çdo formë njoftimi për promovimin e lojërave të fatit, qëllimi i dukshëm i së cilës është dhënia e informacionit publikut në medien e shkruar dhe audiovizive.

5. “Miratimi për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit” (më poshtë Miratim) është akti administrativ, me anë të të cilit organizatori i lojërave të fatit ka të drejtë të ushtrojë veprimtarinë në këtë fushë: kazino elektronike, bingo tradicionale, bingo televizive, baste sportive dhe baste për gara në pistë.

6. “Licencë” është akti administrativ, i lëshuar nga autoriteti i parashikuar në ligj, me anë të të cilit organizatori i lojërave të fatit ka të drejtë të ushtrojë veprimtarinë e lojërave për kazino dhe lotari kombëtare.

7. “Lojtar” është personi që merr pjesë në lojërat e fatit, sipas rregullave të përcaktuara në lojën e fatit.

8. “Rregullore e lojës së fatit” është tërësia e rregullave të propozuara nga organizatori i lejuar/licencuar i lojës, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e organizuesit dhe të pjesëmarrësit në lojën e fatit, si dhe kushtet për ushtrimin e lojës së caktuar dhe rregullat e lojës.

9. “Aplikim” është kërkesa që i drejtohet autoritetit të parashikuar në ligj për t’u pajisur me licencë për organizimin e lojërave të fatit, sipas dispozitave të këtij ligji.

10. “Fondi i ngurtësimit” është shuma, e cila ngurtësohet nga organizatorët e lojërave të fatit, në një bankë të caktuar, me seli në Republikën e Shqipërisë, në favor të Ministrisë së Financave, si garanci për fituesit e lojërave të fatit.

11. “Lojë fati promociionale” është loja, që promovon produkte ose shërbime, në të cilën pjesëmarrësit mund të konkurrojnë për çmime apo bonuse.

12. “Bast” është vendosja e një çmimi ose para nga një lojtar për rezultatin e një ngjarjeje.

13. “Pajisje basti” janë pajisjet kompjuterike, bileta ose çdo gjë tjetër, e përdorur për zhvillimin e lojërave për baste.

14. “Hipodrom” është një vend apo një stadium për organizimin e garave në pistë.

15. “Baste për gara në pistë” është vendosja e basteve për rezultatin e garave me kuaj ose me qen, të administruara në hipodrom.

16. “Baste sportive” janë bastet e vendosura jo për garat e pistave.

17. “Lotari kombëtare” janë të gjitha lojërat e lotarisë, që mund të ofrohen vetëm nga mbajtësi i licencës për lotari kombëtare.

18. “Videolotari” (më poshtë VLT) është lotaria e luajtur nëpërmjet videoterminalëve, të lidhura me një sistem rrjetesh elektronike, ku rezultati i lojës mbështetet në shansin e prodhuar nga serveri, bazuar në gjenerimin e numrave të rastësishëm.

19. “Pajisje lotarie” janë pajisje kompjuterike, përfshirë terminalin e VLT-së, bileta ose çdo gjë tjetër, të përdorura për zhvillimin e lojërave të lotarisë.

20. “Kredit” është mundësia që i jepet një personi të paguajë, pasi shërbimi të jetë kryer, nëpërmjet dhënies hua të parave ose ekuivalentit të parave, por nuk përfshin përdorimin e parapagimit me kartë në vend të parave cash.

21. “Kazino elektronike” është mjedisi, ku lojtarëve u ofrohet mundësia për të luajtur me makina elektronike të tipit slot dhe makina elektronike me shumë lojtarë dhe videolotari.

22. “Kazino” është mjedisi ku lojtarëve u ofrohet mundësia për të luajtur me mjetet e lojërave të fatit, si makina të tipit slot, videolotari ose makina elektronike, me shumë lojtarë, si dhe tryeza loje, sipas përkufizimit përkatës të dhënë.

23. “Makina elektronike” është pajisja, e cila lejon një ose më shumë lojtarë të luajnë pa ndërhyrjen e njeriut.

24. “Makinë slot” është një makinë loje, nëpërmjet së cilës vetëm një lojtar mund të lejojë të luajë, në të njëjtën kohë, e cila ka një mekanizëm gjenerues të numrave të rastësishëm, të instaluar në makinë, që përcakton rezultatin e lojës.

25. “Makinë elektronike me shumë lojtarë” është makina e lojës, nëpërmjet së cilës mund të luajnë, në të njëjtën kohë, më shumë se një lojtar, e cila ka një mekanizëm gjenerues të numrave të rastësishëm, të instaluar në makinë, që përcakton rezultatin e lojës.

26. “Tryezë loje” është pajisje loje, ku një ose më shumë lojtarë mund të luajnë, në të njëjtën kohë, së bashku me shpërndarësin e letrave dhe/ose zareve, që më poshtë do të quhet “kupjer”.

27. “Bingo tradicionale” është loja ku, nga hedhja e shortit, dalin aq numra sa nevojiten për të pasur një fitues. Në këtë lojë pjesëmarrësit luajnë brenda një salle dhe pajisen me bileta të caktuara, të cilat përmbajnë një grup numrash, pjesë përbërëse të një grupi tjetër të caktuar numrash.

28. “Bingo televizive” është bingo tradicionale, e luajtur jashtë sallave, e cila e bën publike hedhjen e shortit nëpërmjet medias televizive.

29. “Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit” (NJMLF) është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Financave.

30. “QKR” është Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Neni 5

Llojet e lojërave të fatit

Llojet e lojërave të fatit, që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë, janë:

1. Baste sportive;
2. Baste për gara në pistë;
3. Kazino;
4. Kazino elektronike;
5. Lotari kombëtare;
6. Bingo tradicionale;

7. Bingo televizive.

Neni 6

Mbrojtja e të miturve

Organizatorit i ndalohet të punësojë persona nën moshën 18 vjeç, si dhe të lejojë personat nën moshën 18 vjeç të futen apo të luajnë në mjediset e lojërave të fatit.

Neni 7

Mbrojtja e lojtarit

1. Në mjedisin ku luhen lojërat e fatit duhet të ekspozohet gjithmonë një tabelë e dukshme, paralajmëruese për lojtarët, për të treguar mundësinë e ndikimit negativ nga lojërat e fatit.

2. Ndalohet ndërtimi/marrja me qira e mjediseve, me fushë veprimtarie lojëra fati, të ekspozuara pranë institucioneve fetare, arsimore dhe shëndetësore.

3. Përmbytja e paralajmërimeve, sipas pikës 1 të këtij neni dhe largësia ndaj institucioneve, sipas pikës 2 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 8

Ndalimi i nxitjes për të marrë pjesë në lojërat e fatit

1. Ndalohet ofrimi, ndihma ose nxitja e një loje apo e lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Ndalohet zhvillimi i lojërave *on-line*, nëpërmjet internetit, nga shoqëritë e miratuara dhe të licencuara, sipas këtij ligji, përjashtuar shoqëritë e basteve sportive. NJMLF-ja ka të drejtë të kërkojë bllokimin e faqeve të internetit të shoqërive që ofrojnë zhvillimin e lojërave *on-line*.

Neni 9

Publiciteti i lojërave të fatit

1. Ndalohet publiciteti për lojëra fati në një mënyrë që shfaqet veçanërisht për të miturit, ose që i paraqet lojërat e fatit si zgjidhje të problemeve financiare.

2. Ndalohet publiciteti në medien e shkruar dhe audiovizive, me përjashtim të buletineve informative të vetë organizatorit të lojës. Njoftimet e shoqërive në teletekstet e medie vizive dhe shpërndarja e buletineve informative janë vetëm për lojtarët dhe jo për publikun.

KREU II

LEJIMI I USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË LOJËRAVE TË FATIT, KRIJIMI ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I NJËSISË SË MBIKËQYRJES SË TYRE

Neni 9/1

Licencimi

(Shtuar me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)

Veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë XII.3, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.

Neni 10

Rregulla të përgjithshme

1. Bastet sportive, bastet për garat në pistë, kazinotë elektronike, bingot tradicionale dhe bingot televizive lejohen të organizohen nga çdo subjekt, që përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij, pasi ka marrë miratimin e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

2. Autoriteti i autorizuar për dhënien e licencave, pranë Këshillit të Ministrave, i jep licencë për kazino dhe për lotari kombëtare aplikantit, që shpallet fitues në një procedurë gare, e cila zhvillohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

3. Ministri i Financave u jep autorizim subjekteve publike ose private, për të organizuar lojëra fati promociionale, nëpërmjet shitjes dhe tregtimit të mallrave apo në ndonjë mënyrë tjetër gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, për efekt promovimi ose publiciteti të mallit. Mënyrat, format, kriteret dhe rregullat shtesë për organizimin e lojërave të fatit promociionale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Shoqëria për organizimin e basteve sportive, basteve për garat në pistë, kazinosë elektronike, bingos apo bingos televizive regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në organet tatimore, në përputhje me legjislacionin, për regjistrimin e subjekteve dhe procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë:

a) brenda 30 ditëve përpara hapjes së veprimtarisë, shoqëria duhet ta paraqesë të gjithë dokumentacion e kërkuar, sipas nenit 19 dhe dispozitave të këtij ligji për miratim të NJMLF-ja;

b) shoqëria për organizimin e basteve sportive, të basteve për garat në pistë, kazinosë elektronike, bingos apo bingos televizive mund ta ushtrojë veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) për hapjen e çdo salle, ku do të ushtrohet veprimtaria, organizatori (shoqëria) është i detyruar të njoftojë NJMLF-në 30 ditë përpara hapjes së veprimtarisë dhe të pajiset me NIPT-in sekondar për çdo vendndodhje dytësore të biznesit;

ç) organizatori (shoqëria) duhet të njoftojë NJMLF-në, brenda 30 ditëve për mbylljen e çdo salle, ndryshimin e selisë, të personelit apo të numrit të mjeteve të lojërave për çdo sallë, në përputhje me miratimin që zotëron;

d) në sallën e lojërave të fatit mund të ushtrohet veprimtari nga më shumë se një organizator, i lejuar për lojëra fati;

dh) procedura për hapjen dhe mbylljen e sallave/kazinove elektronike, ku zhvillohet veprimtaria e lojërave të fatit, përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

5. Shitja, lënia peng dhe çdo formë tjetër e disponimit të aksioneve të organizatorit të lejuar për zhvillimin e lojërave të fatit, bëhen me njoftim të NJMLF-së. Kjo procedurë

përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 11

Rregullorja e lojërave të fatit

Rregullorja e lojës së fatit propozohet nga organizatori i lojës dhe miratohet nga NJMLF-ja.

Rregullorja detyruesisht duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe selinë e organizuesit;
- b) emrin, përshkrimin dhe kohëzgjatjen e lojës së fatit;
- c) kushtet për pjesëmarrje në lojën e fatit;
- ç) vendin, ku organizohet loja, përkatësisht, territorin, ku bëhet shitja e biletave;
- d) çmimin individual të biletës, përkatësisht kombinacionet;
- dh) afatin e fundit për pjesëmarrje në lojë;
- e) sasinë dhe vlerën monetare të biletave të shitura;
- ë) fondin e fitimit dhe llojin e fitimeve;
- f) përshkrimin e biletës dhe të fletëpagesës;
- g) mënyrën, procedurën dhe mbikëqyrjen e tërheqjes, përkatësisht mënyrën e verifikimit të fitimeve;
- gj) mënyrën e publikimit të shumave të fondit fitues dhe të rezultateve të lojës;
- h) mënyrën dhe afatin e pagesës së fitimeve monetare;
- i) mënyrën e njohjes së pjesëmarrësit në lojë me rregullat;
- j) procedurat në rastin e revokimit të tërheqjes;
- k) çdo dokumentacion të kërkuar nga NJMLF-ja.

Neni 12

Krijimi dhe statusi i NJMLF-së

1. Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së organizatorëve të licencuar në fushën e lojërave të fatit, krijohet Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

2. NJMLF-ja është person juridik publik, me seli në Tiranë, në varësi të Ministrit të Financave.

3. NJMLF-ja financohet nga të ardhurat e veta.

4. Shoqëritë e miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit derdhen në Buxhetin e Shtetit 0,5 për qind të xhiros vjetore, por jo më pak se:

- a) 2 000 000 (dy milionë) lekë në vit për shoqëritë e licencuara për kazino dhe lotari kombëtare;
- b) 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë në vit për shoqëritë që organizojnë kazino elektronike;
- c) 1 000 000 (një milion) lekë në vit për shoqëritë që organizojnë baste sportive dhe baste për gara në pistë;
- ç) 300 000 (treqind mijë) lekë në vit për shoqëritë që organizojnë bingo tradicionale e televizive.

5. Mënyra dhe afatet e kryerjes së pagesës përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 13

Funksionet e NJMLF-së

Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit ushtron këto funksione:

a) mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e subjekteve, që organizojnë lojëra fati, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin për këtë veprimtari dhe aktet nënligjore në fuqi;

b) vendos masën e gjobës në rastet kur vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji;

c) kontrollon dhe verifikon nëse mjetet e lojërave të fatit janë të certifikuara nga trupa të akredituar, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj. Certifikon pajisjet e basteve, sipas specifikimeve teknike, të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave;

ç) mbikëqyr dhe kontrollon subjektet e pajisura me autorizim nga Ministri i Financave, për luajtjen e lojërave promocionale të fatit;

d) mban regjistrin për subjektet, që ushtrojnë këtë veprimtari dhe të sallave të hapura prej tyre, në të gjithë territorin e vendit, për numrin e automateve/pajisjeve për çdo sallë loje dhe karakteristikat specifike të tyre, numrin e punonjësve dhe kualifikimin përkatës të tyre, numrin e biletave të lotarisë kombëtare të hedhura në treg dhe ato të shitura, numrin e shorteve të hedhura nga organizatori i lotarisë kombëtare dhe organizatorët e bingos televizive;

dh) kontrollon dhe verifikon të ardhurat dhe fitimin e subjekteve të licencuara në lojërat e fatit, si dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore prej tyre, të rakorduara në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe degët e saj në rrethe.

2. Shtypja dhe prodhimi i biletave bëhen çdo muaj, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. NJMLF-ja njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të gjitha të dhënat, që kanë lidhje me tatim-taksat.

4. Kur një person fizik apo juridik e zhvillon veprimtarinë në fushën e lojërave të fatit në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose pa licencën përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i autorizuar për dhënien e saj, inspektorët e NJMLF-së vendosin gjobë, bllokojnë veprimtarinë dhe sekuestrojnë pajisjet e lojërave të fatit, sipas dispozitave të kreut IX të këtij ligji.

Neni 14

Struktura dhe organika e NJMLF-së

1. Struktura dhe organika e NJMLF-së miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Titullari i NJMLF-së emërohet nga Ministri Financave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. NJMLF-ja përbëhet nga inspektorë kontrolli, inspektorë certifikimi për mjetet e lojërave dhe inspektorë të zbatimit të masave shtrënguese.

4. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e NJMLF-së rregullohen me Kodin e Punës dhe me aktet e tjera nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 15
Raportimi i NJMLF-së

1. NJMLF-ja raporton për veprimtarinë e saj te Ministri i Financave.
2. NJMLF-ja raporton në afate të përcaktuara dhe sa herë i kërkohet, para Ministrit të Financave për rregullsinë e zhvillimit të veprimtarisë së subjekteve të licencuara në fushën e lojërave të fatit, për kontrollet e ushtruara, rezultatet e tyre, si dhe për sanksionet e vendosura.
3. NJMLF-ja paraqet te Ministri i Financave, brenda tremujorit të parë të çdo viti, raportin vjetor të veprimtarisë për vitin pararendës.

Neni 16
Inspektimi

1. Inspektimi i veprimtarisë së çdo personi juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e lojërave të fatit, kryhet nga inspektorët e NJMLF-së.
2. Inspektorët e NJMLF-së pajisen me dokument të posaçëm identifikimi. Ata kryejnë inspektim në mjediset, ku personi fizik apo juridik zhvillon veprimtarinë pa e njoftuar paraprakisht, për të verifikuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.
3. Çdo person juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e lojërave të fatit, është i detyruar t'i lejojë inspektorët të kryejnë inspektimin kudo ku ka pajisje të lojërave të fatit, si dhe t'u ofrojë inspektorëve të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar prej tyre.

KREU III
ORGANIZIMI I BASTEVE

Neni 17
Kërkesat për të lejuar ushtrimin e veprimtarisë së basteve

1. Asnjë person nuk mund të organizojë ose të zhvillojë baste, në qoftë se nuk plotëson detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij.
2. Të gjitha bastet, të cilat nuk vendosen në kohë reale në serverin qendror të organizatorit për ngjarje sportive të papërsëritshme apo të zhvilluara në kohën, kur rezultati i ngjarjeve sportive është pothuajse i vendosur dhe i përcaktuar, janë të ndaluara.

Neni 18
Pagesa për ushtrim veprimtarie për bastet

Personi juridik, i cili ushtron veprimtarinë për lojërat e fatit për baste dhe ka plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 19 të këtij ligji, duhet të bëjë pagesat e mëposhtme vjetore:

a) për ushtrim veprimtarie për baste sportive, 2 000 000 (dy milionë) lekë për shoqërinë, pranë organit tatimor, ku është regjistruar subjekti juridik. Pagesa bëhet një herë në vit, brenda muajit janar, në njërën nga bankat e vendit, për llogari të organit tatimor. Nëse organizatori e fillon veprimtarinë në gjashtëmujorin e parë të vitit, pagesa bëhet e

plotë, ndërsa nëse veprimtaria fillohet në gjashtëmujorin e dytë të vitit paguhen 1 000 000 (një milion) lekë;

b) për ushtrim veprimtarie për baste për garat në pistë, 2 000 000 (dy milionë) lekë për shoqërinë, pranë organit tatimor, ku është regjistruar subjekti juridik. Pagesa bëhet një herë në vit brenda muajit janar, në njërën nga bankat e vendit, për llogari të organit tatimor. Nëse organizatori e fillon veprimtarinë në gjashtëmujorin e parë të vitit, pagesa bëhet e plotë, ndërsa nëse veprimtaria fillohet në gjashtëmujorin e dytë të vitit paguhen 1 000 000 (një milion) lekë.

Neni 19

Kriteret për lejimin e organizimit të basteve

1. Kriteret për organizimin dhe ushtrimin e lojërave të fatit për baste sportive dhe/ose baste për gara në pistë, janë si më poshtë:

a) të jetë shoqëri anonime, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku në objektin e veprimtarisë të pasqyrohet veprimtaria për lojëra fati, sipas llojit të lojës që kërkohet;

b) të ketë NIPT-in e shoqërisë;

c) të ketë kapitalin themeltar të shoqërisë jo më i vogël se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

ç) të vetëdeklarojë aksionarët e shoqërisë, ata që kontrollojnë paketën kryesore të aksioneve, si dhe të japë informacion për kapitalet dhe interesat e aksionarëve në shoqëri të tjera të përbashkëta ose jo të përbashkëta;

d) të deklarojë burime të mjaftueshme financiare për të organizuar lojëra fati;

dh) të paraqesë rregulloren e lojës, sipas nenit 20 të këtij ligji;

e) të ketë një marrëveshje paraprake për të bashkëpunuar me njërën nga bankat me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave;

ë) të paraqesë ekstraktin nga QKR-ja, ku të vërtetohet se shoqëria nuk është në proces falimentimi apo likuidimi, nuk është dënuar për shkelje penale, si dhe nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, që lidhet me veprimtarinë profesionale;

f) të ketë dokumentin e certifikimit të mjeteve të lojërave, sipas dispozitave të këtij ligji;

g) të bëjë pagesën për fondin e ngurtësimit për fituesit e lojërave të fatit menjëherë, përpara paraqitjes së dokumentacionit administrativo-ligjor, sipas këtij ligji.

2. Përveç NIPT-it, kriteret e mësipërme vërtetohen nëpërmjet dokumenteve të lëshuara brenda 3 muajve të fundit nga data miratimit të tyre nga organet përgjegjëse shtetërore, si dhe duhet të jenë origjinale apo të noterizuara.

3. Nëse aplikanti është person juridik i huaj, dokumentacioni i mësipërm paraqitet në formën e deklaratës me shkrim, nën përgjegjësinë e tij, nëse këto vërtetime nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës.

Neni 20

Rregullorja e lojërave të fatit për bastet

Rregullorja e lojës së fatit propozohet nga organizatori dhe miratohet nga NJMLF-

ja.

Rregullorja detyrimisht duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe selinë e organizuesit;
- b) emrin, përshkrimin dhe kohëzgjatjen e lojës së fatit;
- c) kushtet për pjesëmarrje në lojë e fatit;
- ç) vendin, ku organizohet loja, përkatësisht territorin, ku bëhet shitja e biletave;
- d) çmimin individual të biletës, përkatësisht kombinacionet;
- dh) afatin e fundit për pjesëmarrje në lojë;
- e) sasinë dhe vlerën monetare të biletave të shitura;
- ë) fondin e fitimit dhe llojin e fitimeve;
- f) përshkrimin e biletës dhe të fletëpagesës;
- g) mënyrën, procedurën dhe mbikëqyrjen e tërheqjes, përkatësisht mënyrën e verifikimit të fitimeve;
- gj) mënyrën e publikimit të shumave të fondit fitues dhe rezultateve të lojës;
- h) mënyrën dhe afatin e pagesës së fitimeve monetare;
- i) mënyrën e njohjes me rregullat të pjesëmarrësit në lojë;
- j) procedura, në rastin e revokimit të tërheqjes;
- k) çdo dokumentacion të kërkuar nga NJMLF-ja.

Neni 21

Organizimi i basteve *on-line*, në servera të dedikuar, të certifikuar, të njohur dhe të monitorueshëm nga NJMLF-ja

1. Organizatori i basteve sportive, për komunikimin *on-line* ose jo, duhet të instalojë pajisje bastesh me një siguri të lartë, që të përputhen minimalisht me këto kërkesa:

- a) zona qendrore ku mbahen serverat e ku përpunohen kuotat dhe informacionet e tjera duhet të jetë e pajisur me një sistem kontrolli, që të regjistrojë çdo person, që hyn dhe del në këtë zonë, datën, orën dhe identifikimin e personit dhe ta ruajë regjistrimin për të paktën një periudhë 3- mujore;
- b) zona duhet të ketë kamera, të tipit CCTV, ku të gjitha pajisjet e lidhura të jenë të dukshme, në mënyrë të qartë;
- c) zona duhet të jetë e ruajtur gjatë të gjithë kohës;
- ç) zona duhet të ketë një rrjet pajisjesh monitoruese që mund të kontrollohen nga NJMLF-ja ose inspektorët e saj.

Për bastet që zhvillohen *on-line*, i gjithë sistemi duhet të operojë mbi një server të dedikuar, autorizuar për administrimin e basteve, të monitorueshëm nëpërmjet kredencialeve përkatëse të NJMLF-së. Serveri në fjalë duhet të përmbushë të gjitha kushtet e nivelit të lartë të sigurisë, të sistemeve mbrojtëse, kundrejt ndërhyrjeve të rrezikshme nga elementë të rrezikshëm për dëmtimin e të dhënave dhe daljen jashtë pune të këtyre serverave.

2. Administratori i basteve sportive të luajtura *on-line* ose jo duhet:

- a) të ofrojë të drejta hyrëse për përfaqësuesit e NJMLF-së dhe të strukturës përgjegjëse për lojërat e fatit në zonën, ku janë vendosur pajisjet e basteve;
- b) të marrë më parë miratimin paraprak nga struktura përgjegjëse për lojërat e fatit, për çdo ndryshim material të sistemit, përpara se ky ndryshim të bëhet fakt nga organizatorët;

- c) të sigurojë që vetëm personat e autorizuar prej tij do të kenë të drejta hyrëse në zonën, ku janë të vendosura pajisjet e basteve;
- ç) të sigurojë që nuk do të ketë asnjë ndërhyrje në të dhënat e sistemit;
- d) të regjistrojë, paraprakisht, çdo lojtar që do të marrë pjesë në baste, për shumën të luajtura ose të fituara që kalojnë vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë, si dhe të marrë të dhëna për identitetin e tyre;
- dh) nuk duhet të pranojë nga lojtarët para *cash*, por pagesa duhet bërë vetëm nga llogaria bankare, me kartë krediti a debiti ose nga portofoli elektronik, i regjistruar nga klienti në një institucion financiar të njohur;
- e) duhet t'i paguajë lojtarët fitues sa më shpejt të jetë e mundur, vetëm nga llogaria, ku janë depozituar pagesat dhe vetëm në llogarinë në emër të fituesit;
- ë) nuk duhet të lejojë asnjë lojtar të mbajë më shumë se një llogari me administratorin;
- f) duhet të mbajë në një llogari bankare fondet e lojtarëve, të ndara nga fondet e tjera të pronësisë së shoqërisë dhe me kusht që kjo llogari të jetë në një institucion të pranueshëm nga NJMLF-ja;
- g) duhet t'u ofrojë lojtarëve mbështetje, të paktën nëpërmjet telefonit ose *e-mail*-it;
- gj) duhet t'i paraqesë NJMLF-së një raport mujor të shumave apo të pagesave të bëra nga klientët, si dhe të detyrimeve a pagesave të fituesve;
- h) duhet të zbatojë procedura dhe masa siç mund të kërkohen nga NJMLF-ja.

KREU IV ORGANIZIMI I LOJËRAVE NË KAZINO ELEKTRONIKE

Neni 22

Lejimi i mjeteve elektronike

1. Asnjë shoqëri nuk mund të organizojë ose të përdorë mjete elektronike në kazino elektronike, në qoftë se nuk plotëson detyrimet e përcaktuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij.
2. Në një kazino elektronike duhet të ketë jo më pak se 10 mjete elektronike për çdo sallë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë në kazino elektronike, shoqëria duhet të ketë paguar shumën 1 000 000 (një milion) lekë pranë organit tatimor, ku është regjistruar subjekti juridik. Pagesa bëhet një herë në vit brenda muajit janar. Në rast se shoqëria e fillon veprimtarinë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit, pagesa bëhet e plotë, 1 000 000 (një milion) lekë. Në rast se shoqëria e fillon veprimtarinë në gjashtëmujorin e dytë të vitit, pagesa është 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
4. Vetëm organizatori, që ka plotësuar kriteret për kazino elektronike, duhet të përdorë tabelë me emërtimin “Kazino elektronike” në mjediset ku i zhvillon këto lojëra.

Neni 23

Kriteret e lejimit për zhvillimin e lojës “Kazino elektronike”

1. Kriteret për organizimin dhe ushtrimin e lojërave të fatit në kazinonë elektronike janë si më poshtë:

a) të jetë shoqëri anonime, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku në objektin e veprimtarisë të pasqyrohet veprimtaria për lojëra fati, sipas llojit të lojës që kërkohet;

b) të ketë NIPT-in e shoqërisë;

c) kapitali themeltar i shoqërisë të jetë jo më i vogël se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

ç) të vetëdeklarojë aksionarët e shoqërisë, ata që kontrollojnë paketën kryesore të aksioneve, si dhe të japë të dhëna për kapitalet dhe interesat e aksionarëve në shoqëri të tjera, të përbashkëta ose jo të përbashkëta;

d) të deklarojë burime të mjaftueshme financiare për të organizuar lojëra fati;

dh) të paraqesë rregulloren e lojës, sipas nenit 20 të këtij ligji;

e) të ketë një marrëveshje paraprake për të bashkëpunuar me njërën nga bankat, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave;

ë) të paraqesë ekstraktin nga QKR-ja, ku të vërtetohet se shoqëria nuk është në proces falimentimi apo likuidimi, nuk është dënuar për shkelje penale, si dhe nuk është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, që lidhet me veprimtarinë profesionale. Vërtetimi të jetë edhe për secilin aksionar të shoqërisë;

f) të bëjë pagesën për fondin e ngurtësimit për fituesit e lojës, përpara paraqitjes së dokumentacionit administrativo-ligjor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

g) të deklarojë adresën, ku do të hapet kazinoja elektronike, si dhe numrin e mjeteve elektronike;

gj) të paraqesë dokumentin e certifikimit të mjeteve elektronike, në përputhje me nenin 24 të këtij ligji.

2. Përveç NIPT-it, kriteret e mësipërme vërtetohen nëpërmjet dokumenteve të lëshuara brenda 3 muajve të fundit nga data miratimit të tyre, nga organet përgjegjëse shtetërore, si dhe duhet të jenë origjinal apo të noterizuara.

Neni 24

Specifikimet teknike të makinave elektronike

1. Çdo makinë elektronike duhet:

a) të jetë në përputhje me rregullat/direktivat e zbatueshme të sigurisë së BE-së.(EC Safety regulations);

b) të jetë në përputhje me standardet e BE-së;

c) të jetë e pajisur me deklaratën e përputhshmërisë së BE-së;

ç) të jetë e pajisur me certifikatën e prodhimit, certifikatën e origjinës dhe dokumentet e zhdoganimit;

d) të përmbajë lojëra në përputhje me kërkesat e pikës 2 të këtij neni;

dh) të ketë një gjenerues rastësor numrash (random number generator) (RNG), të instaluar në të, i cili duhet të plotësojë kërkesat e kësaj dispozite;

e) të jetë e plumbosur nga NJMLF-ja me vulën përkatëse;

ë) të ketë memorie fiskale për transferimin e të dhënave të xhiros on-line tek organet tatimore.

2. Çdo lojë e një makine elektronike:

a) duhet të ketë përshkrimin e duhur, i cili duhet të përfshijë:

- i) titullin e lojës;
 - ii) numrin serial;
 - iii) rregullat e luajtjes së saj;
- b) duhet të ketë rezultate të rastësishëm, të përcaktuara nga një gjenerator numrash të rastësishëm, të vendosur në makinën elektronike.

3. Gjeneruesi rastësor i numrave (RNG), i instaluar në të, duhet të jetë i miratuar nga një laborator testues, ndërkombëtar ose kombëtar, (pjesë e piramidës/hierarkisë së sistemit të cilësisë), i akredituar për software-t e lojërave, në bashkëpunim me NJMLF-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit/Standardeve. Ky laborator duhet të jetë i certifikuar, sipas standardeve ndërkombëtare ISO EN 17025 ose ISO EN 17020. Duhet të jetë lëshuar një certifikatë miratimi nga laboratori i sipërpërmendur, e cila duhet të përmbajë përshkrimin e RNG-së dhe të funksionimit të tij, përfshirë rastësinë dhe normativën e pagesës.

4. Çdo makinë e certifikuar dhe e miratuar duhet të ketë të ngjitur, në një vend të dukshëm, pullën e rregullsisë, e cila duhet të përmbajë elementet e sigurisë së këtyre pajisjeve, përfshirë:

- a) numrin unik serial;
- b) hologramën;
- c) emrin ose kodin e certifikatës/licencës për vënien në funksionim të makinave të lojërave të fatit;
- ç) formën dhe ngjyrën e saj origjinale, e cila mund të ndryshojë çdo 3 muaj apo pas çdo kohe të vendosur nga NJMLF-ja.

5. Pullat e rregullsisë lëshohen dhe vendosen te çdo makinë nga NJMLF-ja.

6. Pulla është e vlefshme për një periudhë njëvjeçare nga data e miratimit.

7. Ekstremitetet e pullës së rregullsisë përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 25

Certifikimi dhe miratimi i video-lotari-terminaleve (VLT)

1. Asnjë shoqëri nuk mund të vendosë apo të ofrojë lojëra sipas konceptit/funksionimit të VLT-së, deri në çastin që VLT-ja të certifikohet dhe të miratohet (nëse kjo VLT përmbush specifikimet teknike të tipit të saj) nga NJMLF-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë e Akreditimit, e cila afishon në një vend të dukshëm, kërkesat sipas përcaktimit të pikës 5 të këtij neni.

2. Çdo VLT duhet:

a) të jetë e shoqëruar me certifikatën e plotë dhe korrente dhe me deklaratën e konformitetit;

b) të ketë certifikatën e prodhimit, certifikatën e origjinës dhe dokumentet e zhdoganimit;

c) të jetë e plumbosur nga NJMLF-ja;

ç) të ketë memorie fiskale për transferimin e të dhënave të xhiros *on-line* tek organet tatimore;

d) të jetë në përputhje me rregullat e direktivat e BE-së, të zbatueshme për sigurinë (EC Safety regulations);

dh) të jetë në përputhje me standardet e BE-së;

e) të jetë e pajisur me deklaratën e konformitetit të BE-së;
ë) të jetë i pajisur me certifikatën e prodhimit dhe certifikatën e origjinës, si dhe me dokumentet e zhdoganimit;
f) të përmbajë lojëra, në përputhje me kërkesat e pikës 3 të këtij neni;
g) të jetë e plumbosur nga NJMLF-ja me vulën përkatëse;
gj) të ketë memorie fiskale për transferimin e të dhënave të xhiros *on-line* tek organet tatimore.

3. Çdo lojë në një VLT duhet të ketë:

a) përshkrimin e duhur, ku përfshihen:

i) titulli i lojës;

ii) numri serial;

iii) rregullat e luajtjes së saj;

b) rezultate të rastësishme të përcaktuara nga një gjenerator numrash të rastësishëm, të vendosur në serverin qendror, tek i cili VLT-ja në fjalë së bashku me VLT-të e tjera të përdorura për videolotari janë të lidhura (*connected*);

c) të paktën normativën e pagesës 80 për qind (të përcaktuar mbi një cikël minimal prej 200 000 lojërash, të luajtura ose të simuluar, për t'u luajtur).

4. Një gjenerator numrash të rastësishëm (RNG) në serverin qendror, kur VLT-të e përdorura në videolotaritë janë të lidhura:

a) duhet të jetë i miratuar nga një laborator testues ndërkombëtar ose kombëtar (pjesë e piramidës së sistemit të cilësisë), i akredituar për *software-t* e lojërave, në bashkëpunim me NJMLF-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit/Standardeve. Ky laborator duhet të jetë i certifikuar, në bazë të standardeve ndërkombëtare ISO EN 17025 ose ISO EN 17020;

b) duhet të ketë një certifikatë miratimi, dhënë nga laboratori i sipërpërmendur, e cila duhet të përmbajë përshkrimin e RNG-së dhe funksionimin e tij, përfshirë rastësinë dhe normativën e pagesës.

5. Çdo VLT, e certifikuar dhe e miratuar, duhet të ketë gjatë të gjithë kohës, të afishuar (të ngjitur) në një vend të dukshëm “Pullën e rregullsisë”, të vlefshme, e cila duhet:

a) të përmbajë elementet e sigurisë së këtyre pajisjeve, përfshirë:

i) numrin unik serial;

ii) hologramën;

iii) emrin ose kodin e certifikatës/licencës për operimin e makinave të lojërave të fatit;

iv) formën dhe ngjyrën e saj origjinale, e cila mund të ndryshojë çdo 3 muaj apo pas çdo kohe, të vendosur nga NJMLF-ja;

b) të sigurohet dhe të fiksohet në çdo pajisje të lojërave të fatit, të certifikuar/miratuar ekskluzivisht, nga NJMLF-ja;

c) të jetë e vlefshme për një periudhë 3-mujore ose për aq kohë, sa vendoset nga NJMLF-ja.

KREU V

ORGANIZIMI I LOTARISË KOMBËTARE

Neni 26

Lejimi i luajtjes së lojërave të lotarisë kombëtare

1. Autoriteti i parashikuar nga ligji ka të drejtë të japë licencën “Lotari kombëtare” për një periudhë 10-vjeçare. Kjo licencë është një e vetme dhe i jepet aplikantit, i cili përzgjidhet i pari në procesin e konkurrimit, të zhvilluar sipas procedurave të përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore, dalë në zbatim të tij.

2. Licenca e lotarisë kombëtare përfshin:

a) të gjitha lojërat numerike, ku një numër është tërhequr nga një radhë e paracaktuar numrash;

b) “Keno”, si në formën tradicionale, ashtu edhe në atë elektronike;

c) lotari, për të cilat hidhet short, ku lojtari synon të fitojë një shumë të caktuar, nëse nga hedhja e shortit, që bëhet në mënyrë publike, fiton numri, që shënohet në biletën e zgjedhur prej tij;

ç) lotari e çastit, ku lojtarit i ofrohet mundësia të bëjë vetë fshirjen e shiritit mbulues të numrit të shënuar, brenda një intervali kohor të caktuar, gjatë të cilit është e vlefshme seria e biletës së lotarisë.

3. Aplikanti, për marrjen e licencës për lotarinë kombëtare duhet të paguajë menjëherë një shumë prej jo më pak se 300 000 000 (treqind milionë) lekësh, në njërën nga bankat e vendit, për llogari të organeve tatimore.

4. Organizatori për lotari kombëtare duhet të njoftojë NJMLF-në për të gjitha lojërat që do të ofrohen, si të përcaktuara në këtë nen për çdo ndryshim të rëndësishëm të ndonjë loje, për çdo vend ku ai ushtron veprimtarinë për lojëra lotarie, si dhe për çdo pagesë të fituesve.

Neni 27

Procedura e hapjes së garës për lotarinë kombëtare

1. Autoriteti i autorizuar nga ligji shpall hapjen e garës për dhënien e licencës për lotarinë kombëtare, pas autorizimit të dhënë me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli i Ministrave miraton kriteret e vlerësimit të garës, dokumentet standarde, strukturën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

3. Autoriteti i autorizuar nga ligji publikon njoftimin për konkurrim në lojërat e fatit për lotari kombëtare, të paktën në një gazetë të huaj, me qarkullim ndërkombëtar, në dy gazeta, që botohen në vendin tonë, në dy numra radhazi, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.

4. Njoftimi duhet të përmbajë:

a) vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumenteve;

b) gjuhën e paraqitjes së dokumenteve;

c) mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;

ç) vendin, orën dhe datën e shqyrtimit të dokumenteve.

Neni 28

Kriteret e licencimit për lotarinë kombëtare

1. Çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose të huaj, pas

shpalljes së ftesës për ofertë, nga autoriteti i autorizuar nga ligji ka të drejtë të aplikojë pranë kësaj strukture, për t'u pajisur me licencë për lotari kombëtare.

2. Kërkesa për licencën për lotari kombëtare shoqërohet me dokumentet e mëposhtme, me kushtin që këto dokumente të jenë brenda 3 muajve nga data e miratimit nga organet përgjegjëse shtetërore:

a) dokumentet origjinale apo të noterizuara, që vërtetojnë se aplikanti është i organizuar në formë shoqërie aksionare apo bashkim shoqërisht, si dhe aktin e themelimit të shoqërisë dhe statutin;

b) kapitali i shoqërisë të jetë jo më i vogël se 1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë) lekë;

c) vetëdeklarimin se nuk është në proces falimentimi apo likuidimi;

ç) një kopje të noterizuar të lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit;

d) dokumentin, ku të shënohet se ka një përvojë në këtë veprimtari jo më pak se 3 vjet, të dhënë nga organi përkatës i vendit, ku aplikanti ka selinë qendrore;

dh) deklaratën për burimin e kapitalit, që do të investohet për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lotarisë kombëtare;

e) vërtetimin nga organet tatimore, për shlyerjen, si nga shoqëria që aplikon, ashtu edhe nga çdo subjekt juridik, në rast bashkimi shoqërisht, të detyrimeve ndaj shtetit;

ë) vërtetimin se ka personel të kualifikuar në ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, të vërtetuara me dokumentacionin përkatës, i cili dorëzohet në çastin e aplikimit në ministrinë përgjegjëse për ekonominë;

f) rregulloren përkatëse për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të lojës, për të cilën kërkon të licencohet;

g) plan-biznesin për zhvillimin e veprimtarisë lotari kombëtare.

3. Kërkesa për licencë për lotari kombëtare përfshin, gjithashtu:

a) të dhëna personale për aksionarët kryesorë të shoqërisë, që kontrollojnë paketën kryesore të aksioneve dhe pronarët kryesorë përfutues;

b) të dhëna për organet drejtuese të aplikantit;

c) të dhëna financiare për kryerjen e biznesit të aksionarëve të aplikantit, për 3 vitet e fundit, përpara paraqitjes së kërkesës;

ç) vetëdeklarimin nga aksionarët e shoqërisë dhe përfaqësuesit në organet drejtuese të saj se nuk janë në ndjekje penale;

d) një marrëveshje paraprake, të paktën me njërën nga bankat, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave;

dh) çdo informacion tjetër, që mund t'i kërkohej aplikantit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe që gjykohej i nevojshëm për veprimtarinë që do të ushtrohet.

4. Kundërshtimi, refuzimi, si dhe privilegjet e kërkuara nga aplikanti, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në shkronjën “d” të pikës 3 të këtij neni, përbëjnë shkak ligjor për refuzimin e kërkesës nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Neni 29

Përzgjedhja e subjektit

1. Përzgjedhja e subjektit për lojërat e fatit lotari kombëtare bëhet nga autoriteti i autorizuar nga ligji, në përputhje me kriteret e vlerësimit, të përcaktuara me vendim të

Këshillit të Ministrave.

2. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të vetëdeklarojnë, nën përgjegjësinë tyre, se pjesëmarrja në këtë komision nuk përbën shkak për lindjen e një konflikti interesi me subjektet pjesëmarrëse në konkurrim. Për mosdeklarim zbatohen masat e parashikuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përfundim, shpall listën e pjesëmarrësve në konkurrim, duke filluar renditjen nga aplikanti, që ka marrë numrin më të madh të pikëve. Kandidati, që ka marrë numrin më të madh të pikëve, shpallet fitues.

4. Kur aplikanti, i renditur i pari në listë, nuk vazhdon procedurat për marrjen e licencës, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së tij fitues, skualifikohet dhe shpallet fitues konkurrenti i renditur i dyti, sipas listës së miratuar.

Në rast se edhe konkurrenti i dytë nuk vazhdon procedurën për marrjen e lejes, autoriteti i autorizuar nga ligji urdhëron përsëritjen e garës.

Neni 30

Njoftimi i fituesit për lotarinë kombëtare

1. Pas miratimit të listës së pjesëmarrësve në konkurrim, autoriteti i autorizuar nga ligji urdhëron publikimin e njoftimit të fituesit në faqen zyrtare të internetit. Brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së njoftimit, aplikanti ka të drejtë të paraqesë çdo ankesë, pranë autoritetit të autorizuar nga ligji, për procedurën e zhvilluar.

2. Autoriteti i autorizuar, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës, përfundon shqyrtimin administrativ dhe njofton ankuesin për vendimin e marrë.

3. Me përfundimin e afatit për paraqitjen e ankesave, autoriteti i autorizuar nga ligji miraton dhënien e licencës për lotari kombëtare, pasi aplikanti i shpallur fitues të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) aplikanti, vendas apo i huaj, i shpallur i pari në listë, brenda 30 ditëve, duhet të bëjë pagesën për marrjen e licencës, në shumën e përcaktuar në këtë ligj, të paraqesë fondin e garancisë, të lëshuar nga një bankë, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, në favor të Ministrisë së Financave, si garanci për fituesit e lojërave;

b) aplikanti i huaj, i shpallur i pari në listë, brenda 30 ditëve duhet të regjistrohet si person juridik shqiptar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 31

Certifikimi i pajisjeve të lotarisë kombëtare

1. Asnjë pajisje nuk do të përdoret nga i licencuari për lotari kombëtare, nëse ajo nuk është certifikuar dhe miratuar si pajisje lotarie nga NJMLF-ja.

2. Këshilli i Ministrave vendos minimumin e specifikimeve teknike, që duhet të kenë pajisjet e lotarive, për t’u vlerësuar të ligjshme për përdorim në administrimin e lojërave.

3. I licencuari për lotari duhet të njoftojë NJMLF-në për secilën dhe për çdo tip të pajisjeve, që do të përdoren, për çdo lojë lotarie, duke siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm që kjo njësi të verifikojë dhe të konfirmojë të gjitha specifikimet teknike dhe standardet e çdo pajisjeje të lotarive.

4. Një pajisje lotarie vlerësohet e certifikuar dhe e miratuar, nëse përmbush specifikimet teknike, të vendosura nga Këshilli i Ministrave.

5. Nëse një tip i veçantë pajisjeje është i certifikuar, atëherë të gjitha pajisjet e këtij lloji duhet të certifikohen.

KREU VI ORGANIZIMI I KAZINOSË

Neni 32

Lejimi i luajtjes së lojërave në kazino

1. Autoriteti i autorizuar ka të drejtë të japë licencën për kazino për një periudhë 10-vjeçare.

a) Licenca i jepet aplikantit, i cili përzgjidhet i pari në procesin e garës, të zhvilluar sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij.

b) Për marrjen e licencës, aplikanti duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji, si dhe të paguajë menjëherë shumën 1 000 000 000 (një miliard) lekë, për Tiranën dhe 300 000 000 (treqind milionë) lekë për kazinotë në zonat turistike, në njërën nga bankat e vendit, për llogari të organeve tatimore.

2. Autoriteti i autorizuar ka të drejtë t'i japë licencën për kazino, për një periudhë 10-vjeçare, pa procedurë gare, aplikantit, që plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 34 të këtij ligji dhe kundrejt pagesës, kur kazinoja është pjesë e një resorti apo projekti të rëndësishëm turistik, i miratuar si pjesë e masterplanit për zhvillimin e turizmit, ndërtimi i të cilit është miratuar nga organet përkatëse.

Neni 33

Procedura e hapjes së garës për kazino

1. Këshilli i Ministrave, me vendim, përcakton zonat, ku mund të hapen kazinotë dhe numrin e kazinove, për çdo zonë. Organizatori i pajisur me licencë nuk mund të hapë më shumë se një kazino.

2. Autoriteti i autorizuar publikon hapjen e garës për dhënien e licencës për kazino, pas autorizimit me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili miraton kriteret e vlerësimit të garës, dokumentet standarde dhe strukturën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

3. Autoriteti i autorizuar publikon njoftimin për konkurrim në lojërat e fatit për kazino, të paktën në një gazetë të huaj, me qarkullim ndërkombëtar, në dy gazeta, që botohen në vendin tonë, në dy numra radhazi, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.

4. Njoftimi duhet të përmbajë:

a) vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumenteve;

b) gjuhën e paraqitjes së dokumenteve;

c) mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;

ç) vendin, orën dhe datën e shqyrtimit të dokumenteve.

Neni 34

Kriteret e licencimit për kazino

1. Çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose të huaj, pas shpalljes, nga autoriteti i autorizuar, ka të drejtë të aplikojë pranë kësaj strukture, për t'u pajisur me licencë për kazino.

2. Kërkesa për licencën për kazino duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme, me kushtin që këto dokumente të jenë marrë brenda 3 muajve nga data e miratimit nga organet përgjegjëse shtetërore:

a) dokumentet origjinale apo të noterizuara, që vërtetojnë se aplikanti është i organizuar në formë shoqërie aksionare apo bashkim shoqërisht, si dhe aktin e themelimit të shoqërisë e statutin;

b) dokumentacionin, ku vërtetohet se kapitali i shoqërisë është jo më i vogël se 1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë) lekë;

c) vetëdeklarimin, që aplikanti nuk është në proces falimentimi apo likuidimi;

ç) një kopje të noterizuar të lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit, nëse ka, të dhënë nga organi përkatës i vendit, ku aplikanti ka selinë qendrore;

d) deklaratën për burimin e kapitalit, që do të investohet për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinosë;

dh) vërtetimin nga organet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi, për shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, si nga shoqëria që aplikon, ashtu edhe nga çdo subjekt juridik, në rast bashkimi shoqërisht;

e) dokumentacionin përkatës, që vërteton se ka personel të kualifikuar në ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, i cili dorëzohet në çastin e aplikimit në autoritetin e autorizuar nga ligji;

ë) rregulloren përkatëse për mënyrën e funksionimit të lojës.

f) plan-biznesin për zhvillimin e veprimtarisë për licencën për kazino;

g) planimetrinë e vendosjes së mjediseve për organizimin e lojërave, pjesën e hotelërisë dhe të shërbimeve të akomodimit, të bareve, restoranteve dhe shërbimeve të tjera të këtij lloji e të veprimtarive zbavitëse;

gj) dokumentin, që vërteton përvojën e subjektit në fushën e kazinove.

3. Informacioni, që shoqëron kërkesën për licencë për kazino, përfshin, gjithashtu:

a) të dhëna personale për aksionarët kryesorë të shoqërisë, që kontrollojnë paketën kryesore të aksioneve dhe pronarët kryesorë përfitues;

b) të dhëna për organet drejtuese të aplikantit;

c) të dhëna financiare për kryerjen e biznesit të aksionarëve të aplikantit, për 3 vitet e fundit, përpara paraqitjes së kërkesës;

ç) vetëdeklarimin nga aksionarët e shoqërisë dhe të përfaqësuesit në organet drejtuese të saj se nuk janë në ndjekje penale;

d) një marrëveshje paraprake, të paktën me njërin nga bankat, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave;

dh) çdo informacion tjetër, që mund t'i kërkohej aplikantit nga autoriteti i autorizuar dhe që gjykohej i nevojshëm nga ai për fushën e veprimtarisë që do të ushtrohet.

4. Kundërshtimi, refuzimi, si dhe privilegjet e kërkuara nga aplikanti, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në shkronjën "dh" të pikës 2 të këtij neni, përbëjnë shkak ligjor për refuzimin e kërkesës nga autoriteti i autorizuar nga ligji.

Neni 35

Përzgjedhja e subjektit

1. Përzgjedhja e subjekteve për lojërat e fatit kazino bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, si autoriteti i autorizuar nga ligji, sipas kriterëve të vlerësimit, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të vetëdeklarojnë, nën përgjegjësinë e tyre, se pjesëmarrja në këtë komision nuk përbën shkak për lindjen e një konflikti interesi me subjektet pjesëmarrëse në konkurrim. Për mosdeklarim zbatohen masat e parashikuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, shpall listën e pjesëmarrësve në konkurrim, duke filluar renditjen nga aplikanti, që ka marrë numrin më të madh të pikëve. Aplikanti, që ka marrë numrin më të madh të pikëve, shpallet fitues.

4. Kur aplikanti, i renditur i pari në listë, nuk vazhdon procedurat për marrjen e licencës, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së tij fitues, skualifikohet nga autoriteti i autorizuar nga ligji dhe shpallet fitues konkurrenti i renditur i dyti, sipas listës së miratuar.

5. Nëse edhe konkurrenti i dytë nuk vazhdon procedurën për marrjen e licencës, autoriteti i autorizuar nga ligji urdhëron përsëritjen e garës.

Neni 36

Njoftimi i fituesit për kazino

1. Pas miratimit të listës së pjesëmarrësve në konkurrim, autoriteti i autorizuar nga ligji urdhëron publikimin e njoftimit të fituesit në faqen e saj zyrtare të internetit. Aplikanti, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së njoftimit, ka të drejtë të paraqesë çdo ankesë pranë autoritetit të autorizuar nga ligji për procedurën e zhvilluar.

2. Autoriteti i autorizuar, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës, përfundon shqyrtimin administrativ dhe njofton ankuesin për vendimin e marrë.

3. Autoriteti i autorizuar, me përfundimin e afatit për paraqitjen e ankesave, miraton dhënien e licencës për kazino, pasi aplikanti i shpallur fitues të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) aplikanti, vendas apo i huaj, i shpallur i pari në listë, brenda 30 ditëve duhet të bëjë pagesën për marrjen e licencës, në shumën e përcaktuar në këtë ligj, të paraqesë fondin e garancisë, të lëshuar nga një bankë, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, në favor të Ministrisë së Financave, si garanci për fituesit e lojërave, të bërë sipas këtij ligji;

b) aplikanti i huaj, i shpallur i pari në listë, brenda 30 ditëve duhet të regjistrohet si person juridik shqiptar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 37

Rregullorja e lojërave të fatit për kazino

1. I licencuari përgatit për secilën lojë, që do të luhet në kazino, rregulloren, të cilën ua bën të njohur pjesëmarrësve në lojëra.

2. Rregulloret e lojërave përfshijnë, kryesisht:

a) rregullat për mënyrën e pjesëmarrjes në lojë dhe përcaktimin e maksimumit dhe të minimumit të shumës, që paguhet për çdo lojë.

b) kushtet për lejin e hyrjes së personave në kazino;

c) orën e hapjes dhe të mbylljes së kazinosë.

3. Miratimi i rregullores së paraqitur nga i licencuari bëhet nga Ministri i Financave, me propozimin e NJMLF-së, në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregulloren e miratuar për këtë qëllim.

Neni 38

Detyrimet e të licencuarit për kazino

Të licencuarit i jepet licencë për zhvillimin e lojërave në kazino, kur, përveç kushteve të parashikuara në dispozitat e këtij ligji, plotëson edhe kushtet e mëposhtme:

a) lojërat zhvillohen në salla të caktuara, paraprakisht, për këtë qëllim;

b) përdor pajisje të standardeve, të njohura bashkëkohore, sipas karakteristikave teknike të përcaktuara me ligj, për të gjitha llojet e lojërave;

c) punëson personel të përshtatshëm, që zotëron njohuri profesionale në këtë fushë.

Personeli i punësuar në kazino duhet të jetë, të paktën, mbi moshën 18 vjeç, të ketë zotësi të plotë juridike edhe për të vepruar, si dhe nuk duhet të jetë dënuar më parë penalisht për vepra penale, të cilat parashikojnë dënim me burgim;

ç) ka miratimin e Ministrisë së Brendshme për masat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, brenda dhe jashtë sallës, ku do të zhvillohen lojërat.

Neni 39

Ndalimet për kazinonë

1. Nëse lojërat e fatit, që zhvillohen në kazino, bien në kundërshtim ose cenojnë interesin e përgjithshëm, me propozimin e Ministrit të Financave, autoriteti i autorizuar nga ligji revokon licencën për zhvillimin e tyre ose ndërpret pa paralajmërim procedurat për dhënie të licencës për organizatorin, që është në proces aplikimi.

2. Rastet kur cenohet interesi i përgjithshëm, në kuptim të pikës 1 të këtij neni dhe kur duhet të zbatohen këto masa, janë:

a) mashtrimi i publikut;

b) pastrimi i parave;

c) cenimi i rendit publik dhe nxitja e kriminalitetit.

KREU VII

ORGANIZIMI I BINGOS TRADICIONALE DHE BINGOS TELEVIZIVE

Neni 40

Lejimi i bingos tradicionale e i bingos televizive dhe pagesat

Pas plotësimit të kriterëve, të përcaktuara në këtë ligj dhe pas njoftimit, brenda 30 ditëve, të NJMLF-së, organizatori i lojërave të fatit bingo tradicionale dhe bingo televizive duhet të bëjë këto pagesa:

a) për ushtrim veprimtarie për bingo tradicionale, shumën 2 000 000 (dy milionë)

lekë në vit, në njërën nga bankat e vendit, për llogari të organit tatimor, ku është regjistruar. Në rast së organizatori e fillon veprimtarinë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit, pagesa bëhet e plotë 2 000 000 lekë. Në rast së organizatori e fillon veprimtarinë në gjashtëmujorin e dytë të vitit do të paguajë 1 000 000 (një milion) lekë;

b) për ushtrim veprimtarie për bingo televizive, 2 000 000 (dy milionë) lekë në vit, në njërën nga bankat e vendit, për llogari të organit tatimor, ku është regjistruar. Në rast së organizatori e fillon veprimtarinë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit, pagesa bëhet e plotë, 2 000 000 (dy milionë) lekë. Në rast së organizatori e fillon veprimtarinë në gjashtëmujorin e dytë të vitit, do të paguajë 1 000 000 (një milion) lekë.

Neni 41

Kriteret e lejimit për organizimin e bingos tradicionale dhe të bingos televizive

1. Kriteret për organizimin dhe ushtrimin e lojërave të fatit për bingo tradicionale dhe bingo televizive, që duhet të plotësojë një organizator për marrjen e miratimit nga NJMLF-ja janë si më poshtë:

a) të jetë shoqëri anonime, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku në objektin e veprimtarisë të pasqyrohet veprimtaria për lojëra fati, sipas llojit të lojës që kërkohet;

b) të ketë NIPT-in e shoqërisë;

c) të ketë kapital themeltar të shoqërisë jo më i vogël se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë për bingo tradicionale dhe jo më të vogël se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë për bingo televizive;

ç) të vetëdeklarojë aksionarët e shoqërisë, ata që kontrollojnë paketën kryesore të aksioneve, si dhe të japë informacion për kapitalet dhe interesat e aksionarëve në shoqëri të tjera, të përbashkëta ose jo të përbashkëta;

d) të deklarojë burime të mjaftueshme financiare, për të organizuar lojëra fati;

dh) të paraqesë rregulloren e lojës, sipas nenit 20 të këtij ligji;

e) të ketë një marrëveshje paraprahe, për të bashkëpunuar me njërën nga bankat, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave;

ë) të paraqesë ekstraktin, nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, ku të vërtetohet se shoqëria nuk është në proces falimentimi apo likuidimi, nuk është dënuar për shkelje penale, si dhe nuk është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, që lidhet me veprimtarinë profesionale. Vërtetimi të jetë edhe për secilin aksionar të shoqërisë;

f) të ketë teknologjinë e nevojshme për luajtjen dhe funksionimin e mjeteve të lojërave të fatit të certifikuara, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj;

g) të krijojë fondin e ngurtësimit për fituesin e lojës, përpara paraqitjes së dokumentacionit administrativo-ligjor, të kërkuar nga ky ligj;

gj) çdo informacion tjetër, që mund t'i kërkohet aplikantit nga NJMLF-ja dhe që gjykohet i nevojshëm për fushën e veprimtarisë, që do të ushtrohet.

2. Në rast të aplikimit për bingo televizive, duhet të paraqiten edhe marrëveshja ndërmjet organizatorit të lojës dhe agentëve për shitjen e biletave, marrëveshja ndërmjet organizatorit të lojës dhe një stacioni televiziv kombëtar për transmetimin e lojës (shorteut) për bingo televizive, strategjia për informimin e klientëve për rregullat e kësaj loje (datën

e hedhjes së shortit, mënyrës e luajtjes, ku do të tërhiqen çmimet, ku do të bëhet transmetimi, nxjerrja e rezultateve), rregulloren e lojës dhe fondin për fituesit, i cili, për çdo lojë, është jo më pak se 50 për qind e shumës nga vlera e arkëtuar nga shitja e biletave.

3. Përveç NIPT-it, kriteret e mësipërme vërtetohen nëpërmjet dokumenteve të lëshuara, brenda 3 muajve nga data e miratimit të tyre, nga organet përgjegjëse shtetërore, si dhe duhet të jenë origjinale apo të noterizuara.

Neni 42

Fondi i garancisë për fituesit e lojërave të fatit

1. Për krijimin e garancive për fituesit e lojërave të fatit, organizatori është i detyruar të ngurtësojë një fond të caktuar, në një llogari të veçantë bankare, në favor të Ministrisë së Financave, i cili zhbllkohet vetëm me urdhër të Ministrit të Financave. Mënyra, forma dhe shuma e garancive përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

2. Mosngurtësimi i fondit të garancisë përbën shkak ligjor për bllokimin dhe mbylljen e veprimtarisë nga NJMLF-ja.

3. NJMLF-ja i propozon Ministrit të Financave zhblokimin e këtij fondi, me kërkesë të organizatorit të lojërave, në rast se vërtetohet se ky i fundit nuk ka detyrime tatimore, nuk ka gjoba të pashlyera, si dhe kur mbyll veprimtarinë e tij, të vërtetuara këto nga organet shtetërore përkatëse.

Neni 43

Pezullimi dhe bllokimi i veprimtarisë

1. NJMLF-ja pezullon për 30 ditë veprimtarinë për ushtrimin e lojërave të fatit dhe/ose propozon, pranë autoritetit të autorizuar, pezullimin e licencës së dhënë për lojëra fati, kur vëren se organizatori nuk shlyen detyrimet ndaj fituesve të lojës, deri në shlyerjen e plotë të tyre.

2. NJMLF-ja konfiskon pajisjet e organizatorit të lejuar/licencuar për lojërat e fatit, sipas ligjit të procedurave tatimore, në rast se:

a) ai nuk zbaton ose shkel detyrimet e parashikuara në dispozitat e këtij ligji dhe në aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij;

b) ai nuk shlyen detyrimet e vendosura nga kjo njësi për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në këtë ligj;

c) miratimi/licenca është marrë në bazë të dokumenteve të rreme;

ç) në përfundim të afatit të pezullimit të miratimit/licencës, ai nuk ka shlyer detyrimet ligjore, për të cilën i është pezulluar miratimi/licenca.

KREU VIII

DETYRIMET TATIMORE

Neni 44

Detyrimet tatimore

1. Fitimet, që organizatori i lojërave të fatit realizon nga ushtrimi i veprimtarisë së tij, janë të tatueshme, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

2. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në bazë të dispozitave të legjislacionit tatimor në fuqi.

3. Të ardhurat, që përfitohen nga lojtarët apo fituesit, që marrin pjesë në lojërat e fatit dhe kazinotë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale.

4. Veprimtaritë e lojërave të fatit, që tatohen sipas dispozitave të këtij ligji, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

5. Detyrimet tatimore janë:

5.1 Për bingo:

a) organizatori i lojës bingo, që zhvillohet për pjesëmarrës, brenda sallës, paguan një tatim për lojërat e fatit, me një kuotë fikse, çdo muaj, për çdo sallë, përkatësisht, 500 000 lekë, për rrethet e llojit të parë, 400 000 lekë, për rrethet e llojit të dytë dhe 300 000 lekë, për rrethet e llojit të tretë;

b) organizatori i lojës bingo televizive, që nuk zhvillohet për pjesëmarrës brenda sallave, paguan tatim për lojërat e fatit 10 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, gjithsej, të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave.

Organizatori, për çdo lojë, duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë.

5.2. Për bastet sportive:

Organizatori i basteve sportive paguan tatim mbi lojërat e fatit 10 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, gjithsej, të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave, por jo më pak se 2 000 000 (dy milionë) lekë në muaj, për çdo shoqëri, që kryen këtë veprimtari.

Organizatori duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë.

Përveç pagesave të shoqërisë për çdo pikë basti duhet të kryhen pagesat në tarifa fikse mujore si më poshtë:

a) për rrethet e llojit të parë, 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë;

b) për rrethet e llojit të dytë, 40 000 (dyzet mijë) lekë;

c) për rrethet e llojit të tretë, 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për zhvillimin e sporteve, i kalojnë në favor 0,2 për qind të shumave të grumbulluara, sipas këtij neni.

5.3. Për kazino elektronike:

Organizatori i lojërave për kazino elektronike paguan tatim fiks mujor, si më poshtë:

a) për rrethet e llojit të parë, 400 000 (katërqind mijë) lekë për çdo sallë, si dhe 20 000 (njëzet mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot dhe videolotari;

b) për rrethet e llojit të dytë, 200 000 (dyqind mijë) lekë për çdo sallë, si edhe 20 000 (njëzet mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot dhe videolotari;

c) për rrethet e llojit të tretë, 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo sallë, si dhe 20 000 (njëzet mijë) lekë për çdo makinë elektronike tipit slot dhe videolotari;

ç) për çdo makinë elektronike me më shumë se një pozicion (ruletë) organizatori paguan një kuotë fikse mujore prej 1 000 000 lekësh, si dhe 80 000 lekë në muaj për çdo pozicion loje, pavarësisht nga rrethi ku ushtron veprimtarinë.

5.4. Për lojërat e fatit të llojit lotari kombëtare:

Organizatori i lojërave, të përfshira në licencën për lotari kombëtare, paguan tatim për lojërat e fatit, 10 për qind mbi vëllimin e qarkullimit gjithsej. Për çdo lotari, organizatori duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë

në lojë. Për rastet kur shumë në dispozicion të lojtarëve nuk u shpërndahet fituesve, ajo mbartet në lotarinë pasardhëse, si shumë në dispozicion të lojtarëve.

6. Për efekt të këtij ligji, në rrethet e llojit të parë përfshihen Tirana dhe Durrësi, në rrethet e llojit të dytë përfshihen Shkodra, Korça, Vlora, Saranda, Gjirokastra, Elbasani, Fieri, Lushnja, Pogradeci, Berati, Lezha e Kavaja, ndërsa në rrethet e llojit të tretë përfshihen të gjitha rrethet e tjera.

7. Detyrimet tatimore për lojërat e fatit, në përqindje apo në shumë fikse, paguhen në degën e tatim-taksave, ku është e regjistruar shoqëria (organizatori), jo më vonë se data 10 e çdo muaji për veprimtarinë e realizuar në muajin pararendës.

Neni 45

Detyrimi tatimor për kazinotë

1. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

2. Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojërave të fatit në kazino, paguajnë detyrimet tatimore mujore si më poshtë:

a) për tryezat me më shumë se një pozicion (ruletë) një taksë mujore, në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë në muaj për çdo pozicion;

b) për çdo tryezë të lojërave (me letra ose/dhe me zare), një taksë mujore, në masën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë;

c) për lojërat elektronike dhe makinat slot, me fitim në çast dhe për videlotarinë, të vendosura në mjediset e kazinosë, një taksë mujore në masën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për çdo kompjuter elektronik.

3. Bashkisë, ku ushtron veprimtarinë kazinoja, i kalojnë në favor 0,2 për qind të xhiros.

Neni 46

Detyrimi tatimor për bastet për gara në pistë

1. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojërave të fatit në bastet për gara në pistë, paguajnë detyrimet tatimore, si më poshtë:

a) një tatim loje fati, me kuotë fikse, çdo muaj, prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për shoqërinë;

b) një tatim loje fati, me kuotë fikse, çdo muaj, prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh, për çdo pikë të shitjes së basteve;

c) për lojërat elektronike, me fitim në çast, të vendosura në mjediset e hipodromit, një tatim me kuotë fikse, çdo muaj, prej 40 000 lekësh, për çdo kompjuter elektronik ose pozicion të makinës elektronike.

3. Bashkisë, ku ushtron veprimtarinë organizatori, për baste me gara në pistë, i kalojnë në favor 0,2 për qind të xhiros.

KREU IX KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 47

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji nga organizatori i lojërave të fatit, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

Gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë, në rastet kur:

a) organizatori ka ndryshuar selinë dhe adresën e sallave të lojërave të shoqërisë dhe nuk ka njoftuar NJMLF-në;

b) ka ndryshuar personeli i punësuar në shoqëri, pa njoftimet paraprake;

c) ka të punësuar, të pranishëm në mjediset e lojërave të fatit ose lojtarë nën moshën e ndaluar, sipas dispozitave të këtij ligji;

ç) rregulloret e lojërave të fatit nuk janë afishuar në mjediset e lojërave, në mënyrë të dukshme, në dispozicion të lojtarëve, si dhe kur këto mjedise janë të ekspozuara ndaj institucioneve fetare, arsimore dhe shëndetësore;

d) kryhet publicitet për lojëra fati, në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji;

dh) nuk sigurohet kontrolli dhe identifikimi i personave në kazino;

e) vërehet mosfunksionim i sistemit audioviziv në kazino;

ë) të dhënat e depozituara nga shoqëria pranë Ministrisë së Financave, NJMLF-së dhe autoritetit të autorizuar nuk përputhen me ato të konstatuara gjatë kontrollit;

f) vërehet se organizatori ka shkelur kërkesat e këtij ligji;

g) vërehet se deklaratimet e bëra në NJMLF nuk përputhen me deklaratimet e bëra në organet tatimore;

gj) subjekti, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pengon ushtrimin e kontrollit të NJMLF-së;

h) pika nuk është e pajisur me NIPT sekondar për secilën veprimtari të lojërave të fatit që organizohet në të.

2. Në rast përsëritjeje të shkeljeve të mësipërme, NJMLF-ja ka të drejtë të bllokojë dhe të heqë të drejtën për ushtrim veprimtarie, si dhe t'i kërkojë autoritetit të autorizuar nga ligji revokimin/pezullimin e licencës.

3. Dënimi me gjobë për kundërvajtjet administrative vendoset nga inspektorët e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

4. Inspektori i NJMLF-së, që vëren shkelje, harton procesverbalin për vendosjen e gjobës, të cilin ia komunikon organizatorit të lojës.

5. Ushtrimi i veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit, të cilat janë rregulluar me këtë ligj, pa njoftuar NJMLF-në, sipas procedurave të parashikuara nga ky ligj, ose licencuar nga autoriteti i autorizuar nga ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe personi juridik, që kryen kundërvajtjen, dënohet me gjobë, si më poshtë:

a) për bingo e bingo televizive 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë;

b) për lotarinë kombëtare 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë;

c) për bastet sportive 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë;

ç) për kazino elektronike 1 000 000 (një milion) lekë (për çdo makinë);

d) për kazino 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë;

dh) për bastet e garave në pista 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë.

6. Në rast se kundërvajtja administrative kryhet nga personi fizik, pa miratimin/licencën e organeve përkatëse, ky person dënohet me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

Kur NJMLF-ja vendos gjobë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, fleta e gjobës plotësohet në tri kopje, nga të cilat njëra i dorëzohet subjektit kundërvajtës, njëra depozitohet në NJMLF dhe tjetra, brenda 72 orëve nga vendosja e saj, depozitohet në Komisionin e Apelimit të Gjobave. Format i gjobës dhe të dhënat e saj miratohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

7. Organizatorit i konfiskohen pajisjet nga NJMLF-ja kur:

- a) nuk janë certifikuar sipas këtij ligji dhe nuk kanë pullën e rregullsisë;
- b) kjo njësi vëren hapjen e pikave të reja pa njoftim dhe miratim, pa NIPT dhe NIPT sekondar;
- c) veprimtaria është bllokuar dhe subjekti ushtron veprimtari të palejuar.

Neni 48

Ankimi administrativ ndaj gjobës

1. Ndaj dënimit me gjobë, organizatori ka të drejtën e ankimit administrativ te Komisioni i Apelimit të Gjobave, brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për procesverbalin e gjobës.

2. Komisioni i Apelimit të Gjobave përbëhet nga pesë anëtarë:

- a) dy përfaqësues nga Ministria e Financave;
- b) dy përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- c) një përfaqësues nga NJMLF-ja;
- ç) një sekretar.

3. Veprimtaria e Komisionit të Apelimit të Gjobave rregullohet me udhëzim të Ministrit të Financave. Kryetari i Komisionit të Apelimit të Gjobave emërohet nga Ministri i Financave.

4. Mënyra e funksionimit të Komisionit të Apelimit të Gjobave, procedurat e tij operative, procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të anëtarëve dhe mënyra e shpërbërimit të tyre përcaktohen me rregullore të nxjerrë nga Ministri i Financave.

5. Ankimi ndaj masës së gjobës për kundërvajtje administrative duhet të përmbajë këto elemente:

- a) emërtimin e personit ankimues, numrin e NIPT-it, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe adresën e plotë;
- b) objektin, për të cilin ushtron të drejtën e ankimit, duke përmendur të gjitha elementet identifikuese të masës ndëshkimore;
- c) bazën ligjore të pretendimit për ankimin e tij;
- ç) përshkrimin e përmbledhur të arsyeve, fakteve dhe rrethanave, për të cilat ankimohet masa ndëshkimore;
- d) kërkesën përfundimtare;
- dh) kopjen e procesverbalit të masës së gjobës, të vendosur nga inspektori.

6. Komisioni i Apelimit të Gjobave merr vendim, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit, për lënie në fuqi ose jo të gjobës apo për ndryshimin e masës së saj.

Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet në prani të kundërvajtësit. Kur

vërtetohet se ai ka marrë dijeni dhe nuk ka shkaqe justifikuese për mosparaqitje, shqyrtimi mund të bëhet edhe në mungesë.

7. Kundër vendimit të NJMLF-së apo të Komisionit të Apelimit të Gjobave, personi i interesuar, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, gëzon të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit, ku ka selinë subjekti i gjobitur, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në rastet kur kundërvajtësi është person fizik, ankimi bëhet në gjykatën e rrethit, ku është kryer kundërvajtja.

Neni 49

Ekzekutimi i gjobës

1. Gjobat paguhen nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit të Apelimit të Gjobave ose nga data kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet një kamate prej 2 për qind e shumës deri në 1 muaj.

2. Nëse detyrimet nuk shlyhen në mënyrë vullnetare, ekzekutimi i tyre bëhet nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, sipas procedurës së parashikuar për masat shtrënguese në këtë ligj.

Të ardhurat e siguruara nga vjelja e gjobave derdhen 80 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 20 për qind në llogari të NJMLF-së.

Neni 50

Bashkëpunimi i NJMLF-së me strukturat e tjera shtetërore

Për zbatimin e detyrave, me kërkesën e tyre, punonjësit e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit mbështeten nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me strukturat në varësi të saj, për subjektet, që zhvillojnë veprimtari për lojëra fati, janë të detyruara të paraqesin të gjitha deklaratimet mujore, sipas sallave, të deklaruara nga subjektet dhe ndryshimet periodike, pranë NJMLF-së.

Neni 51

Masat shtrënguese

Kur Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit vëren shkelje të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, merr masat e mëposhtme shtrënguese:

- a) bllokimin e veprimtarisë;
- b) konfiskimin e mjeteve të lojërave;
- c) bllokimin e llogarive bankare;
- ç) sekuestrimin e pasurive të regjistruara në emër të subjektit.

Neni 52

Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të subjektit

Nëse subjekti nuk paguan detyrimet e përcaktuara, sipas këtij ligji, brenda afatit të parashikuar në këtë nen, nëpërmjet një urdhri, me shkrim, të Drejtorit të Njesisë së

Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, i kërkohet çdo banke, ku subjekti ka llogari në emër të vet, të mbajë një shumë, e cila duhet të jetë me e vogla ndërmjet:

- a) shumës, që kërkohet të mbahet;
- b) shumës, që rezulton në atë çast në llogarinë bankare të tatimpaguesit.

Neni 53

Masat e sigurimit të detyrimit

1. Nëse subjekti nuk paguan detyrimin brenda afateve të caktuara, sipas këtij ligji, detyrimi sigurohet në favor të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, mbi të gjithë pasurinë e subjektit, në masën e nevojshme, për të përmbushur detyrimin e tij.

2. Masa e sigurimit të detyrimit të papaguar mund të jetë, sipas rastit, barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore. Vendimi për të vendosur një barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore mbi pasurinë e subjektit bëhet me shkrim nga Drejtori i Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

3. Para vendosjes së një barre siguruese dhe/ose barre hipotekore mbi pasurinë e subjektit, ky i fundit duhet të njoftohet me shkrim. Njoftimi duhet të përmbajë të gjithë informacionin për to.

4. Njoftimi mbi barrën siguruese dhe/ose barrën hipotekore duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme, për të identifikuar subjektin, detyrimin e papaguar, pasurinë, objekt të barrës siguruese dhe/ose barrës hipotekore, si dhe kompetencën e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, për të dorëzuar kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit.

5. Formati i njoftimit për masën siguruese dhe/ose barrën hipotekore dhe regjistrat publikë për regjistrimin e tyre parashikohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 54

Ankimi i masës së sigurimit të detyrimit

1. Subjekti ka të drejtë të ankimojë vendimin për masën e sigurimit të detyrimit të papaguar te Drejtori i Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe të kërkojë çlirimin nga sigurimi, vetëm kur ai është ekzekutuar në mënyrë të parregullt. Ankimimi bëhet 30 ditë kalendarike nga çasti i marrjes dijeni për këtë parregullsi.

2. Kur kërkesa e subjektit miratohet nga Drejtori i Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, ndërmerren menjëherë të gjitha masat e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, për zhbllokimin e masës së sigurimit mbi pasurinë e subjektit.

Vendimi futet në dosjen e subjektit.

Nëse drejtori i njesisë nuk e miraton kërkesën, subjekti mund ta ankimojë vendimin, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 55

Sekuestrimi i pasurisë

1. Nëse subjekti nuk paguan detyrimin, sipas afatit të përcaktuar në këtë ligj, Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit mund ta mbledhë detyrimin e papaguar, nëpërmjet sekuestrimit të pasurisë së siguruar, në favor të njesisë, në pronësi të subjektit të detyruar.

2. Ekzekutimi i masës së sigurimit, nëpërmjet sekuestrimit dhe shitjes së pasurisë, sipas këtij kreu, është objekt i dispozitave të ligjit “Për kundërvajtjet administrative” dhe

realizohet nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

3. Urdhri për sekuestrimin e pasurisë bëhet me shkrim nga Drejtori i Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit. Urdhri duhet të identifikojë subjektin, pasuria e të cilit është objekt sekuestrimi, vendndodhjen e pasurisë dhe vlerësimin e detyrimit, për të cilin vihet sekuestroja. Urdhri i dërgohet subjektit me postë rekomande.

4. Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit mund të sekuestrojë pasurinë, sipas detyrimit, vetëm pas vendosjes së masës së sigurisë mbi pasurinë, në përputhje me këtë ligj dhe vetëm 30 ditë kalendarike pas datës, ku urdhri i sekuestrimit është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga subjekti, në formën e parashikuar nga ky ligj.

Neni 56

Urdhri i sekuestrimit

1. Urdhri i sekuestrimit përmban:

- a) shumën e detyrimeve të papaguara;
- b) afatin për pagesën e detyrimeve;
- c) pasurinë që sekuestrohet;
- ç) informacionin për të drejtën e subjektit për ankim administrativ.

2. Nëse objekt i sekuestrimit është paga e subjektit, urdhri përfshin edhe emrin dhe adresën e punëdhënësit të subjektit.

3. Nëse sekuestrimi bëhet për shkak të shkeljes së masës së bllokimit, zbatohet menjëherë dhe prek vetëm sendet, të cilat përdoren për zhvillimin e paligjshëm të lojërave të fatit.

Neni 57

Pasuria, objekt i sekuestrimit

E gjithë pasuria e subjektit është objekt sekuestrimi, në masën e detyrimit të papaguar, përveç sendeve të përcaktuara në nenin 529 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 58

Shitja e pasurisë së sekuestruar

1. Pasuria e sekuestruar shitet në ankand publik, i cili kryhet në përputhje me procedurat dhe kushtet e parashikuara në ligjin për ankandin publik.

2. Të ardhurat nga shitjet përdoren fillimisht për të paguar shpenzimet e shitjes, më pas për të paguar koston administrative, gjokat dhe interesin, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

3. Shuma e mbetur i kthehet subjektit, brenda pesë ditëve pune nga data e përfundimit të ankandit.

Neni 59

Pajisja me armë e inspektorëve

Inspektorët e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit kanë të drejtë të pajisen me armë, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 60
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore, në mbështetje të neneve 27, 29, 31, 33 e 53 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzime, në mbështetje të neneve 7, 10, 12, 13, 24, 42, 47 pika 6 e 48 pika 4 të këtij ligji.

KREU X
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 61
Dispozita kalimtare

1. Mjetet e lojërave të fatit, që përdoren nga organizatorët e këtyre lojërave, duhet të jenë të certifikuara, sipas rregullave specifike, të parashikuara në këtë ligj, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Për të gjitha subjektet e licencuara deri para hyrjes në fuqi të këtij ligji, në llojet e basteve sportive apo bingove, afati i vlefshmërisë është afati i përcaktuar në çastin e lëshimit të tyre.
3. Të gjithë operatorët e tjerë në treg, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, marrin masa për të përshtatur veprimtarinë e tyre me kërkesat e këtij ligji.

Neni 62
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit dhe kazinotë”, i ndryshuar, të gjitha aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 63
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 5984, datë 29.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi